

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi nga Kryeministri - Oligarku ukrainas në arrati merr shtetësinë e Serbisë
ADRESA	https://www.syri.net/rajoni/919377/oligarku-ukrainas-ne-arrati-merr-shtetesine-e-serbis-e/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:17:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 16:59:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ae2fe0f1bb4c1db67cb0772db37bec21f2cc7d086f08bd4fa9943dde57f598b
TEKSTI	6d388f7faee672fb03c5476689bfff697a5f01a3ccde3b480bb2d246606bbd46a
PAMJA	e2fa331940aeaeb10d32776751aa32dfaf232ca20db8d1ab90813193c5c62113

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	09d2f9899765e4bcc8f54859bf78fd821b6f4cf8821f8c4b384b6a4b3409eb9c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/09d2f9899765e4bcc8f54859bf78fd821b6f4cf8821f8c4b384b6a4b3409eb9c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



NDRIM KULLA

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



më të lexuarat

Rodos: Makth i dyfishtë për 44-vjeçaren polake nga 28-vjeçari shqiptar: Ai i mori 15,000 euro dhe kur ajo ia kërko...

Mali i Zi vendos viza për shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia



Oligarku ukrainas në arrati merr shtetësinë e Serbisë

18:59, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Oligarku ukrainas në arrati dhe ish-deputeti Vadym Novynskiy, ndaj të cilit në vendin e tij është lëshuar fletarrestim nën dyshimet për tradhti të lartë, ka marrë shtetësinë e Serbisë.

Vendimi për dhënien e shtetësisë Novynskiyit, i publikuar të premten në Gazetën Zyrtare, ishte nënshkruar një ditë më herët nga kryeministri i Serbisë, Gjuro Macut.

Në vendim, me të cilin anashkalohen procedurat e rregullta, Qeveria e Serbisë i referohet një dispozite ligjore, sipas së cilës një i huaj mund të bëhet shtetas serb përmes një procedure të përsheptuar, nëse kjo përbën "interes" për shtetin.

Qeveria serbe, deri në publikimin e këtij lajmi, nuk iu përgjigj pyetjeve të Shërbimit të Ballkanit të Radios Evropa e Lirë se pse Novynskiyit iu dha shtetësia dhe si përbën kjo interes për Serbinë.

As Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë nuk iu përgjigj pyetjeve.

Novinski është bërë kështu pjesë e qindra shtetasve të huaj, të cilëve autoritetet në Serbi, të udhëhequra nga Partia Përparimtare Serbe e Aleksandar Vuçiçit, ua kanë dhënë pasaportat serbe përmes procedurës së përsheptuar.

Që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, në këtë mënyrë shtetësinë serbe e kanë marrë edhe qindra shtetas rusë, ndërsa REL-i më herët ka konstatuar se shumë prej tyre janë të afërt me regjimin e Vladimir Putin.

Kush është Vadym Novynskiy?

Novynskiy është ish-deputet dhe biznesmen ukrainas, ndaj të cilit, siç raporton Shërbimi ukrainas i REL-it, është lëshuar fletarrestim nën dyshimet për tradhti të lartë, me cilësimin se është "kujdestar i Kishës Ortodokse Ruse në Ukrainë".

Ai u largua nga Ukraina menjëherë pas fillimit të pushtimit rus të këtij vendi në shkurt të vitit 2022 dhe ndërkohë u vendos në Kroaci, ku bleu një pronë me sipërfaqe prej më shumë se 1.400 metrash katrorë, me parcela prej mbi 2.5 hektarësh, ku ndodhen vreshta dhe pemishte.

Në përgjigjen e avokatit të biznesmenit nga një firmë ligjore spanjolle thuhet se Novynskiy është "në ndërkohë i vendosur i Ukrainës" dhe se "në krah të tij është"

Zgjedhjet në Bosnje nën vëzhgimin e figurave të afërta me Kremlinin

Kori nga Beogradi provokon me këngë nacionaliste serbe për Kosovën

Oligarku ukrainas në arrati merr shtetësinë e Serbisë

Vuçiç dhe Sheshel bashkë në zgjedhjet parlamentare në Serbi

Mitsotakis: Qiproja është testi i besueshmërisë së Kombeve të Bashkuara

Novynskiy është një personazh i vendosur i Ukrainës dhe se prej kohësh është nën sanksionet e Federatës Ruse, gjë që në vetvete përjashton çdo pretendim të bazuar për lidhjet e tij të supozuara me strukturat ruse".

Në letërrën e dorëzuar nga avokati nuk paraqiten prova se Novynskiy është nën sanksione të Moskës. Në fakt, më herët është raportuar se sanksionet e Rusisë ndaj tij janë hequr në vitin 2020 dhe se nuk janë vendosur sanksione të reja. Në përgjigjen e avokatit thuhet gjithashtu se "fushatat e drejtuara ndaj diskreditimit, demonizimit dhe kriminalizimit të zotit Novynskiy janë të papranueshme".

Në mars të këtij viti, pas një heshtjeje të gjatë, Novynskiy dha një intervistë për Compact.TV gjerman, e cila u publikua me titullin "Ky oligark dëshiron ta rrëzojë Zelenskyn!" dhe me përshkrimin se ai është "diçka si Elon Musk i Ukrainës: sipërmarrës, politikan dhe një nga njerëzit më të pasur në vend. Tani ai ndiqet nga presidenti Zelensky – sepse kundërshton kursin e tij në luftë".

Në intervistë, biznesmeni kritikon presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelenskyn, dhe shpreh qëndrimet e tij për luftën me Rusinë, gjuhën ruse, Marrëveshjet e Minskut, sanksionet ndaj tij dhe ndalimin e Kishës Ortodokse të Ukrainës – e cila, përkrah Kishës Ortodokse të Ukrainës, është kisha më e madhe në atë vend – dhe e cila konsiderohet e afërt me Moskën dhe Kishën Ortodokse Ruse.

"Gjëja më e rëndësishme për sigurinë e Ukrainës janë marrëdhëniet miqësore me Rusinë. Gjithçka tjetër është marrëzi. Nëse Ukraina ka marrëdhënie të mira fqinjësore, miqësore dhe strategjike me Rusinë, gjithmonë do të kemi siguri", tha Novynskiy në intervistë.

Ai pretendon se u detyrua të largohej nga Ukraina për shkak të paralajmërimeve për ndjekje penale ndaj tij.

Sipas të dhënave të Ukrajinska Pravda-s, Novynskiy u largua nga Ukraina pak para fillimit të pushtimit të plotë – më 10 shkurt 2022, drejt Gjermanisë. Sipas të dhënave nga bazat ruse të fluturimeve të rrjedhura, më 21 shkurt 2022 ai fluturoi nga Rusia drejt Estonisë.

Sipas të dhënave të Shërbimit ukrainas të REL-it, ai u largua nga Ukraina në qershor të vitit 2022 dhe që atëherë nuk është kthyer.

Në korrik të atij viti, ai njoftoi se hiqte dorë nga mandati i deputetit dhe se planifikonte t'i përkushtohej rindërtimit të tempujve të shkatërruar. Në dhjetor të po atij viti, Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes i Ukrainës vendosi sanksione ndaj tij.

Disa muaj më pas, në pranverën e vitit 2023, gazetarët e REL-it e filmuan Novynskiyin në një shërbesë në Kishën Ortodokse Ruse në Cyrih. Në një përgjigje për gazetarët, ish-deputeti tha se ndodhej në Zvicër gjatë një kalimi nga Gjermania.

Më vonë, në verën e vitit 2023, ai u filmua me familjen në një prej resorteve turistike në bregdetin kroat të Adriatikut. Më pas u filmua në hotelin Bellevue në Opatia, në gadishullin e Istrias. Në regjistrin kroat, gazetarët gjetën të dhëna për vendbanimin që ai kishte deklaruar në Split, në kompleksin Bel Etage, bashkëpronarë të të cilit, ndër të tjera, janë shtetas të Rusisë.

Gazetarët e Shërbimit ukrainas të REL-it gjetën një pronë të Novynskiyit në qytetin e tretë kroat – Samobor, pranë Zagrebit. Sipas të dhënave nga Sistemi i Regjistrave të Tokës dhe Kadastrës së Kroacisë, në vitin 2025 ai u bë pronar i një prone luksoze atje.

Prona e ish-deputetit ukrainas përbëhet nga dy parcela me sipërfaqe prej gati 2.5 hektarësh, me vreshta dhe pemishte, si dhe një vilë me sipërfaqe prej më shumë se 1.400 metrash katrorë. Në kompleksin rezidencial përfshihen gjithashtu një ndërtesë banimi prej 265 metrash katrorë, ndërtesa ekonomike dhe një bodrum vere prej 200 metrash katrorë.

Brenda vilës ndodhet gjithashtu një pishinë, ndërsa në tokë ka edhe një fushë golfi. Në njoftimin për shitjen e kësaj rezidence, ajo është quajtur "një nga ndërtesat më të bukura të banimit në Kroaci". Gazeta kroate Jutarnji list raportoi se Novynskiy bleu këtë pronë për 10.5 milionë euro nga biznesmeni lokal Tomislav Horvatinçiq.

"Gjithmonë kam mbështetur paqen, rivendosjen e marrëdhënieve me Rusinë. Edhe pas fillimit të luftës, kam mbështetur paqen, ruajtjen e jetëve të ukrainasve dhe ruajtjen e shtetësisë ukrainase", tha Novynskiy në intervistën e re.

Shërbimi ukrainas i REL-it ka konstatuar se kompania e vëllait të Novynskiyit në Krime, nën pushtimin rus, "punon" për ushtrinë ruse dhe mbështet agresionin ndaj Ukrainës.

Kompania Balaklavka Rudarska Udruga, e cila më parë ishte pjesë e grupit të

S'zbatoi direktivat e BE, Komisioni Evropian nis procedurat kundër Greqisë

KE: Takimi von der Leyen-Vuçiç, spontan dhe i shkurtër

kompanive Smart-Holding të Novynskiyit dhe e cila në vitin 2014 iu transferua vëllait të tij, vazhdon të nxjerrë lëndë minerale dhe paguan qindra miliona rubla taksa në buxhetin e Rusisë. Përveç kësaj, kompania dhe punonjësit e saj ndihmojnë dhe mbështesin ushtrinë ruse gjatë pushtimit të Ukrainës – në burime publike raportohet për riparimin e pajisjeve ushtarake dhe pjesëmarrjen në projekte vullnetare në mbështetje të ushtarëve rusë.

Kush janë shtetasit e rinj të Serbisë?

Një analizë e mëhershme e REL-it tregon se që nga fillimi i luftës, me vendim të Qeverisë serbe, shtetësinë e Serbisë e kanë marrë më shumë se 300 shtetas rusë.

Ky nuk është numri përfundimtar, pasi shtetësitë i jep edhe Ministria e Punëve të Brendshme – përmes procedurës së rregullt, me plotësimin e kushteve të caktuara.

MPB-ja serbe nuk iu është përgjigjur pyetjeve të REL-it se sa shtetas rusë e kanë marrë shtetësinë e Serbisë që nga viti 2022.

REL-i më herët ka gjetur se në mesin e pronarëve të rinj të pasaportave serbe kishte edhe figura publike ruse, politikanë dhe biznesmenë, të cilët janë në "listën e zezë" të vendeve perëndimore për shkak të mbështetjes së tyre për luftën.

Për këtë arsye, Beogradi zyrtar është nën vëzhgimin e Bashkimit Evropian (BE).

Brukseli ka paralajmëruar se pasaporta serbe u mundëson shtetasve rusë të hyjnë në BE pa viza, gjë që paraqet rrezik potencial për sigurinë./ REL.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kori nga Beogradi provokon me këngë nacionaliste serbe për Kosovën



Zgjedhjet në Bosnje nën vëzhgimin e figurave të afërta me Kremlinin



VIDEO/ Nga qelia në 'Arrest shtëpie': Apeli liron Eduard Limajn, nis sërish përndjekjet e grave

TË NGJASHME



S'zbatoi direktivat e BE, Komisioni Evropian nis procedurat kundër Greqisë



Mitsotakis: Qiproja është testi i besueshmërisë së Kombeve të Bashkuara



Zjarr i madh në një tragjet pranë Mykonos, evakohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion



Mali i Zi vendos viza për shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia



Rodos: Makth i dyfishtë për 44-vjeçaren polake nga 28-vjeçari shqiptar: Ai i mori 15,000 euro dhe kur ajo ia kërkoi...



Athinë/ Shpërthim i fuqishëm në një ndërtesë në Plaka, një kalimtar u plagos, dy gra u shpëtuan



Armët nga Bosnja dhe lidhjet e rrjeteve kriminale në Suedi me Iranin: Çfarë zbulon hetimi?

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.